



## NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

### PRN111 NSh"Përparimi" Prishtinë

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

NSh NAPREDAK" Pristina – 1985  
"NAPREDAK" Industrija Namestaja, Deonicarsko Društvo u Mesovitoj Svojini sa Potpunom  
Odgovornoscju 1992  
Kompani me Aksione të Përbashkëta për Përpunimin e Drurit "PËRPARIMI"  
Export - Import me përgjegjësi të plotë - 2000  
Fi-6248/92 me datën 09.11.1992  
KAP- Përparimi- UNMIK registration 80232080, 2000

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 12 qershor 2017 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 25 maj 2017.

**Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrojë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.**

**Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 20 qershor 2017 dhe përfundon me datë 04 gusht 2017 në orën 16:00.**

Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta kenë informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.

**Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit** mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.

**Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Rajonale në Prishtinë**  
**Rexhep Mala, nr.2**  
**Prishtinë, 10 000**  
**Telefoni: +381 38 226 889**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **"Formularët-Udhëzime për plotësim"**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.